



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr.10, Datë 20.01.2021

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GERTI” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA HEC “VARDARI” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1972 KW”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 germa “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1 germa “a”, nenit 10 pika 3 dhe nenit 11 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19 pika 1, germa “a” të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr.9/6 prot, datë 15.01.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 5 Prot, datë 06.01.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Vardari, me vendndodhje në perroiin e Vardarit dhe Valit, dege e Përroit të Zallit të Kostinjes, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.
- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 17.03.2000 konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” i ndryshuar, me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “GERTI” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
 - **Formati dhe dokumentacioni për aplikim**, Neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”.
Plotësuar.

- **Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor**, Neni 9, pika 2, germat “c”, “e”, “f”, “g”. **Plotësuar.**
 - **Dokumentacioni financiar dhe fiskal**, Neni 9, pika 3, germat “b”, “d”. **Plotësuar.**
 - **Dokumentacioni teknik për HEC**, Neni 9, pika 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”. **Plotësuar.**
 - **Leje nga institucione të tjera.**, Neni 9, pika 4.1.5., germat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
- Ne lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Nenin 9, pika 2, Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor:

- **germa “a”/“b”** (akti i themelimit/statuti), **Pa plotësuar.** Shoqëria “GERTI” sh.p.k., ne vijim do te depozitoje Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj ne ERE.
- **germa “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Plotësuar pjesërisht.** Sa konstatuar ne ekstraktin e QKB-së shoqëria veprimtarinë e saj e ushtron edhe zonën e Librazhdit (zona ku do te zhvillohet projekti I HEC-it Vardari). Si e tille, kjo shoqëri përveç vërtetimeve te gjendjes gjyqësore të lëshuara nga qarku i Dibrës (ku ndodhet selia kryesore e saj), duhet të përcjelle në ERE edhe ato të qarkut të Elbasanit.
Në vijim shoqëria do të depozitoje në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë se Qarkut Dibër për administratorin e saj dhe Vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë se qarkut Elbasan, për vete shoqërinë dhe administratorin e saj.

Neni 9, pika 3Dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- **germa “a”** (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit te Sigurimeve Shoqërore). **Plotësuar pjesërisht.** Shoqëria ne vijim do te përcjelle në ERE vërtetimin ne lidhje me sigurimet shëndetësore dhe shoqërore në formën standarde në të cilën lëshohen këto lloj vërtetimesh.
- **germa “c”** (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financimi dhe struktura e financimit (financim i vete aplikuesit, kredi bankare, donacion, etj), **Plotësuar pjesërisht.** Duke qene se vërtetimi i gjendjes se llogarisë bankare, që shoqëria ka depozituar në ERE nuk arrin të mbuloje gjithë vleren e investimit, në vijim shoqëria do të përcjelle dokumentacion financiar mbështetës për financimin e HEC Vardari, do te njoftohet shoqëria qe ne bazë të neneve 10 pika 10 dhe 11 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, që ti paraqesë ato brenda afateve.

- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë (data e përfundimit 07.08.2027) me Bashkinë Librazhd, do ti kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuar, një muaj pas nënshkrimit të rinovimit. Në vijim do ti kërkohet shoqërisë të përcjellë në ERE edhe finalizimin e procedurës në lidhje me heqjen nga fondi pyjor kullësor të sipërfaqes së përcaktuar për HEC Vardari.
- Në përfundim të afati të lejes së shfrytëzimit të burimit ujor (data e përfundimit 16.10.2022), do ti kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuar, një muaj pas nënshkrimit të rinovimit të saj.
- Shoqërisë GERTI sh.p.k., do ti kërkohet informacioni në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e HEC –it, apo në fazën në të cilën ndodhet projekti, në mënyrë që të mundësohet një llogaritje me korrekte e vlefshmërisë së Lejes Mjedisore, në këtë aplikim.
- Kontrata nr. 118 REP., nr. 62/2 KOL., datë 24.01.2018, *“Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Vardari me kapacitet 1.972 MW, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjes, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan”*, lidhur midis MIE dhe Mbajtësit të Miratimit shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k., **të drejtat dhe detyrimet e të cilit i janë transferuar me pas shoqërisë “GERTI” sh.p.k., nëpërmjet Amendimit të Kontratës** me nr. 1818 Rep., dhe nr. 388/2 Kol., date 24.12.2020, *“Për Kontratën e Ndërtimit shfrytëzimit dhe administrimin e hidrocentralit “Vardari me kapacitet 1.972 MW, në përroin e Vardarit dhe Valit, degë e Përroit të Zallit të Kostenjes, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan”*, ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE në zbatim të nenit 38 të Ligjit *“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*, i ndryshuar dhe nenit 5 të *“Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”*, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GERTI” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vardari”; me kapacitet të instaluar 1972 kW, për një afat 30 vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.